



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR



Nr. 36 prot.

Çorovodë më: 21.06.2022

NJOFTIM

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Skrapar

I nderuar Këshilltar,

Ju njoftoj se ditën e hënë më datë 27. 06. 2022, ora 11⁰⁰, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë, zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Skrapar, e thirrur nga Kryetare e Këshillit në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 53, pika 4, me këtë rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26. 05. 2022
3. Deklarimet e konfliktit të interesave.
4. Projektvendim, “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2022”.
5. Projektvendim, “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Skrapar, në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimevetë furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura”.
6. Projektvendim, “Për një ndryshim në VKB Nr. 65, datë 24. 12. 2021, për miratimin e PBA 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”, lidhur me transferimin e buxhetit për rikonstruksionin e zyrave të katit të tretë të godinës së Bashkisë Skrapar.
7. Projektvendim, “Për një ndryshim në VKB Nr. 65, datë 24. 12. 2021, për miratimin e PBA 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”, lidhur me transferimin e buxhetit për hartimin e pjesshëm të projektit për mbarshtrimin e ekonomisë pyjore Turbohovë – Potom”.
8. Projektvendim, “Për miratimin e parcelës me Nr. Pasurie 316/9, për ndërtimin e banesës së shtetasit Hyda Laze, Bogovë”.
9. Të ndryshme.

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

[Signature]

